

Gjykata themelore –Divizioni kundërvajtës ne Prizren, me gjyqtarin Zejnulla Gashi ,dhe procesmbajtësen Melihate Shaipi, ne procedurën kundërvajtës kundër te pandehurit Munir Basha nga Prizreni , per shkak te kundërvajtjes nga neni 5 , 6, par. 1 pik 3, si dhe nenit 9 te Lidhur me nenin 17 par. 1 pika 3 te Ligjit nr. 04/L-050 per Deklarimin , Prejardhjen dhe Kontrollin e pasurisë dhe te zyrtareve te Larte publik dhe ,deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e dhuratave për te gjithë personat zyrtar , e ne baze te nenit 195 al. 1 te LMK, me dt. 09.01.2013 . mori

## A K T V E N D I M

I pandehuri Munir Safet Basha , i lindur ne vitin 1961, nga Prizreni rr` Bekim Berisha – Abeja ` Lamela 9 hyrja e I B, banesa nr. 2, me kombësi shqiptare , Shtetas e Republikës Kosovës, pedagog , i martuar , ka te kryer Fakultetin , i gjendjes se mesme ekonomike.

## E S H T E P E R G J E G J E S E

Për shkak se i njëjti ne cilësinë e zyrtarit se larte publik nuk ka përmbushur obligimin ligjor qe parashihet ne Ligjin nr. 04/L-050 , për Deklarimin , prejardhjen dhe Kontrollin e pasurisë dhe te zyrtareve te Larte publik.

-me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 5 , 6, par. 1 pik 3, si dhe nenit 9 te Lidhur me nenin 17 par. 1 pika 3 te Ligjit nr. 04/L-050 per Deklarimin , Prejardhjen dhe Kontrollin e pasurisë dhe te zyrtareve te Larte publik dhe ,deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtar, I shqiptohet

Gjobe ne shumen prej 500 /Pesëqind/ Euro

I pandehuri obligohet qe dënimin e shqiptuar me gjobe, ta paguaj ne afat prej 15 diteve, nga dita e plotfuqishmërisë se aktvendimit, ne xhirrollogarinë nr.1000430070000518 – Departamenti te çështjeve juridike ,ne te kundërtën gjoba do te zëvendësohet me burg nga 15 Euro per nje dite burg , po ashtu obligohet qe ne afatin e njëjtë te paguaj paushallin gjyqësor ne shumen prej 5 /Pese/ EURO, i pandehuri obligohet qe pas kryerjes se pagesës te njoftoje këtë gjykate.

## A r s y e t i m

Sipas kërkesës te Agjencisë kundër korrupsionit Prishtine me numër 01-1888 te datës 24.05.2012. është ngritur procedura kundërvajtjes kundër te pandehurit Munir Basha nga Prizreni , per shkak te kundërvajtjes nga neni 5 , 6, par. 1 pik 3, si dhe nenit 9 te Lidhur me nenin 17 par. 1 pika 3 te Ligjit nr. 04/L-050 per Deklarimin , Prejardhjen dhe Kontrollin e pasurisë dhe te zyrtarëve te Larte publik dhe ,deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e dhuratave për te gjithë personat zyrtar,

Gjendja faktike e përshkruar me për se afërmi sikurse ne dispozitiv te këtij aktvendimi është vërtetuar ne baze te deklaratës se te pandehurit Munir Basha nga Prizreni , i cili ne deklaratën e dhënë ka pranuar kundërvajtjen me te cilën ngarkohet .Gjykata duke marre parasysh pranimin e përgjegjësisë se te pandehurit per kundërvajtjen e kryer e ka marre si rrethane lehtësuese duke u bazuar ne nenin 9 te LMK-se .

Me rastin e caktimit te dënimit, janë vlersuar rrethanat nen te cilat eshte kryer kundervajtja, pesha e kundervajtjes se kryer dhe shkalla e pergjegjsise se te pandehurit dhe duke patur parasysh rrethanat nga nenit 7 te LMK, te pandehurit i eshte shqiptuar denimi me gjobe me bindje se me kete do te arrihet qelimi i denimit.

DRK / DMP

02

03-220/2013

01.02.2013


03-230/2013/02  
sluzj

Vendimi mbi shpenzimet gjyqesore, eshte marrur ne baze te nenit 109 al.2 te LMK.

Me sa u cek me larte, u vendos si ne dispozitiv te aktvendimit.

Me sa u cek me larte, u vendos si ne dispozitiv te ketij aktvendimi.

GJYKATA KOMUNALE PER KUNDERVJATJE NE PRIZREN  
Nr. 473 -05/2012  
Procesmbajtësja  
Melihate Shaipi



te dt. 09.01.2013.

Gjyqtari  
Zejnulla Gashi

UDHZIMI JURIDIK : Kundër ketij aktvendimi mund te ushtrohet ankese , ne afat prej 8 ditëve, nga dita e pranimit te te njëjtit, Gjykatës se Larte per Kundërvajtje ne Prishtinë, nëpërmjet te kësaj gjykate , pa taksa.